

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **631-21-2961-5-1-1 dhe nr te brendshem : 631-21-017-511**

Sa i përket tenderit për : **Ndërtimi i varrezave të qytetit në Deçan -faza 1**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

” ENGINEERING GROUP “ Sh.p.k.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Lubeniq Deçan

(Adresa)

Lubeniq

30.000

(Vendi)

(Kodi postar)

044/328-623

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Fidan Povataj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

mentishpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

31.05.2021

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrim dhe datë)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi per kontrate 19.02.2021 dorezimi 09.06.2021 ne ora 14:00
- Vlera e parashikuar për kontratë : 1.923.273,00 €
- Kriteret e dhënjes : OE qe paraqet tenderin e përgjegjshem me Çmimin më të ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

Bazuar ne nenin 108/A , Ri-Shqyrtim te kriterëve

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 – Qellimi – i Lpp-së
Neni 6 - Ekoniciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jo-diskriminim
Neni 28 – Specifikimet teknike
Neni 53 – Kërkesa per informacione shtese i Lpp-së

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Neni 1 Qëllimi, Bazuar ne nenin 1 te Lpp-së AK është e obliguar të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla:

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Autoriteti Kontraktues me rastin e perpilimit te kërkesave nuk ka morre per baze nevojat e prokurimit , i ka stergarkuar kriteret qe veshire jane te arritshme per nje numer te caktuar te Operatoreve Ekonomik qe munde te ishin fitues potencial te keti Aktiviteti te prokurimit , pra eshte ne kundërshtim te plote me nenin 1 dhe 6 ku nje AK gjate perpilimit te kërkesave duhet te kete kujdes maksimal qe te mundesoj perfshirjen e sa me shumë Operatoreve Ekonomike .

Neni 7 , Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.
3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohej që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasi të artikujve të tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.
4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.
6. Gjatë udhëheqjes së aktivitetit të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse

Diskriminimi mund të ndodhë në momentin që një OE i cili do të kishte mundësi të realizimit të kontratës ka kapacitete teknike dhe financiare, dhe nuk mund të plotësojë kriteret e kërkuara për më shumë i referohemi paragrafeve 4 deri 11 tek pershtatshmeria profesionale si Iso Standarte që nuk kanë të bëjnë me natyrën e prokurimit dhe Kapaciteti teknik profesional kërkesa 6 dhe 7.

Neni 28 – Specifikimet teknike paragrafi 2 thotë :

Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Në këtë rast ne si OE e konsiderojmë se jemi të diskriminuar dhe nëse shiqohen kontratat paraprake ne kemi realizuar projekt identike dhe me plotë sukses.

Neni 53 Sigurimi i informatave shtese sipas paragrafit 1 si dhe Neni 25 Rruopp , shkelje për mostrajtim adekuat duke mos trajtuar – Refuzuar kërkesën për Ri-Shqyrtim të një OE tjetër me dt. 27.05.2021 të ngarkuar në e-prokurim .

Neni 26 Rruopp , shkelje sepse sipas këtij rregulli një AK mund të kërkojë kërkesa Minimale për përmbushje të kriterit 26.2 duke pasqyruar se që të ofroj mundësi sa më të gjera dhe gjithëpërfshirës të konkurimit.

Arsyetim :

Po kufizohet në masë të madhe mundësia e një përfshirje sa më të gjere të OE të cilët kanë kapacitete humane dhe teknike për realizimin e projektit në fjalë

Kërkojmë nga AK – Komuna e Deçanit respektivisht Menagjeri i prokurimit fillimisht të analizoj Kërkesën tonë konform nenit 108/A të Lpp-së , dhe në bazë të kompetencave që ka të Ri-Shqyrtoj vendosjen e kriterëve dhe të jete i kujdesshem që në bazë të kërkesave për realizim të projektit edhe njesia kerkuese në këtë rast Drejtoria përkatëse të mos vendos kërkesa diskriminuese të procedoj në bazë legjislacionit dytesor për parashtrimin e Kërkesës për Rishqyrtim pranë AK bazuar në F03 Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese

Në kemi vepruar në bazë të nenit 4 nen a), ndërsa

Ju lutemi të veproni në bazë të nenit 6 nen b) dhe me pastaj pas shqyrtimit të Kërkesës sone të marrim VEDNIM bazuar në nenin 8 pika 8.1.2 ii.

Propozojmë bazuar në fushëveprimin e këtij Aktiviteti të Prokurimit se : NDËRTIMI I HAPËSIRËS SË VORREZAVE TË QYTETIT TË DEÇANIT - Punët e terrenit (hapësirës) dhe rrethojës 1. PUNET PËRGADITORE, 2. PUNET E GËRMIMIT DHE MBUSHJES, 3. PUNET E RRETHOJËS - Punët e rrugës dhe parterit brenda parcelës së vorrezave 1. PUNET E DHEUT, 2. PUNET E ZHAVORIT, 3. PUNET E BETONIT (gurë skajor, kubëza dhe asfalt), 4. PUNET E TJERA

Bazuar edhe në paramasën të cilën nuk po e ngarkojmë në këtë Kërkesë për Ri-Shqyrtim por që e kemi përpiluar ju – Njesia Kerkuese si p.s.

Kërkesa 4.Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licenca ISO - ISO 9001 2015 - Certifikimi i sistemit për Menagjimin e Cilesisë, - ISO 39001 2012- Sistemi i Menagjimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor, - PASS 99 2012 - Sistemi i Integruar i Menaxhimit - ISO 14001 2015 - Sistemi i Menaxhimit Mjedisor, - OHSAS 18001 2007 - Sistemi i Menaxhimit të shëndetit dhe Sigurisë në punë, ISO 56003 2019 - Menaxhimi i inovacionit për udhëheqjen e partneritetit, ISO 31000 2009 – Sistemi i menaxhimit të rriskut.

4/1

Kërkesa te pa-Arsyeshme

1. *Pass 99 2012 – Sistemi i Integruar i Menagjimit – Nuk eshte rrjete zingjitor i furnizimit , apo Informata te cilat duhet te trajtohen si sekret shteteror apo diqka me pergjegjesi penale , prandaj duhet te hjeket ky Iso Standard e pa arsyeshme*
2. *OHSAS 18001 2007 - Sistemi i Menaxhimit të shëndetit dhe Sigurisë në punë, nga Qershori 2018 ky Iso Standad eshte i tejkaluar dhe zevendesohet me 45001-2015 , qe per informacion ju lutemi drejtoheni Kompanive te Akredituara per Standartizim dhe do te sqaroheni e pa arsyeshme*
3. *ISO 56003 2019 -Menaxhimi i inovacionit për udhëheqjen e partneritetit – Nuk ka te beje asnje lloje partneriteti e as me inovacione por punë te ndertimit . e pa arsyeshme*
4. *ISO 31000 2009 – Sistemi imenaxhimit te rriskut. Sa per tu informuar Komuna e Deçanit nuk ka kerkuar AUDITIM apo Menagjim te Rriskut por : Nderimin e Varrezave te qytetit , e pa arsyeshme*

Kërkesa 2 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku nga 50 (pesëdhjetë) punëtorë në listën e punëtorëve të paraqitur në ATK për secilin vit, ne tri vitet e shkuara nga publikimi i njoftimit për kontratë

Dëshmi 2 Lista e pagave nga ATK-ja për pagesen e kontributeve se paku 3 vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë

Eshte ne kundërshtim te plote me nenin 7 te Lpk-së sepse Diskriminohen kompanit te cilat kane me pake se tri vite qe e zhvillojn Aktivitetin Ekonomike , dhe ato te cilat pagesat e te punesuarve e kryejn permes Arkes , qe bazuar ne ligjin mbi financat publike e kane nje te drejte te tille , por me kushte qe pagesa e kontributeve personale te paguhet me rregull . – Kriter i cili duhet te modifikohet

Deshmia 3-8 - CV-a (e nënshkruar nga inxhinieri), - Diplomat - Kontrata e punës me ofertuesin

- Leter referencat. - Dëshmi nga ATK-ja për pagesen e kontributeve se paku 1vit - Dëshmi nga Banka (Lista e pagave) të

Operatorit ekonomik që deshmon se ka kryer obligimet ndaj punëtorëve (minimum 50 punëtorë) për 3 muajt e fundit. e nënshkruar dhe vulosur nga banka. Nga publikimi i njoftimit për kontratë

Bankat nuk leshojn Leter Reference apo deshmi per listen e punetoreve nese keta te fundit paguhet me te gatshme , apo paguhet disa nga ta ne banka te ndryshme te licencuara nga BQK ne Republiken e Kosoves.

Kerkes absurde eshte edhe :

Kërkesa 7 Inxhinier i diplomuar i Komunikacionit me tri vite përvojë pune pas diplomimit ose Bahcelor i diplomuar i Komunikacionit me tri vite përvojë pune pas diplomimit. Minimum dy (2) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve).

Ju Lutemi na Sqaroni se sa mund te kete qarkullim pergjate varrezave ne periudhen e ndertimit dhe se si duhet te rregullohet komunikacione ne kete raste.

Te gjitha keto Kriteria Diskriminuese , favorizuese apo edhe percaktuese per Ofertuesit neve na lene shume per te Deshiruar .

5/1

Fakt shumë interesant janë edhe kërkesat në lidhje me kapacitetin teknik :

Kërkesa 9 1(një) Bulldozer D7, 1(një) Makineri-Eskavator, minimum. Pesha 73 t, 3(tre) Makineri-Eskavator, min. Pesha 65 t, 1(një) Eskavator, min. Pesha 50 t, 1(një) Eskavator (dozer) me zingjir, min. Pesha 25 t 4(katër) Eskavator te ndryshëm, 4(katër) Dumper min. Pesha 32 t, 1(një) Dumper min. Pesha 70 t, 3(tre) Dumper min. Pesha 22 t 1(një) Kamion kiper, min. Pesha 40 t, 1(një) Kamion me korpë, 3(tre) Kokë tërheqëse, 18 t, 3(tre) Gjysëmrimorkio kiper min. Pesha 32 t, 1(një) Rimorkio për bartjen e automjeteve min. Pesha 24 t, 3(tre) Kamionetë dubelkabinë, 2(dy) Ngarkues min. Pesha 35 t, 2(dy) Ngarkues min. Pesha 24 t, 2(dy) Cilindër vibrues (makine ngjeshese), 1(një) Cilindër vibrues me dhembëza, min. Pesha 21 t, 1(një) Cilindër vibrues min. Pesha 25 t, 1(një) Grejder (makine për nivelizimin e rrugëve), min. Pesha 14 t, 1(një) Çekan hidraulik, 2(dy) Auto pompë betoni, 4(katër) Kamion për transport të betonit (Autobetonierë - mixer), 1(një) Kamion Cisternë, 1(një) Autobotë, Pajisjet e nevojshme për punët e rrugëve 1(një) Finisher për asfaltimin e rrugëve, 1(një) Makinë (Finisher) më rrota për asfaltimin e rrugëve 1(një) Cilindrat me rrota të kombinuara (gomë dhe hekur), 2(dy) Cilindrat me rrota hekuri me vibrim, 2(dy) Cilindër vibrues min. Pesha 3t, 1(një) Makine për shtrirjen e zhavorrit për bankina të rrugës 1(një) Kamion (Autobotë për pastrimin e rrugëve dhe kanalizimeve), 1(një) Spërkatës për bitumen dhe emulsion, 1(një) Makinë për gërryerjen e asfaltit, 1(një) Kamion special fshisë për pastrimin e rrugëve, 1(një) Prerëse e asfaltit, 1(një) Kompresor, 7(shtatë) Kamion kiper min. Pesha 32 t,

Kërkesa për një Makineri të tillë Aludon në Miniera apo ndonjë levizje Tektonike për të cilin punimet duhet të zhvillohen në thellesi të ujerave, Fiksimi i peshave për makinerit është e kundershtshme për faktin se shumë qarte mund të ndodhë edhe se është Favorizuese për një OE dhe Diskriminuese në raport me OE të tjera.

1(një) Bulldozer D7 – pa alternative, aludohet në vetëm një prodhues

1(një) Makineri-Eskavator, minimum. Pesha 73 t, ju lutemi na sqaroni se në cilin pozicion nga paramasa dhe parallogaria hynë në punë ky Eskavator

3(tre) Eskavator, min. Pesha 65 t, e pa nevojshme

1(një) Eskavator, min. Pesha 50 t, e pa nevojshme

1(një) Eskavator (dozer) me zingjir, min. Pesha 25 t, e pa qartësuar Eskavator apo dozer, dozeri është i ngjashëm me D 7.

4(katër) Eskavator te ndryshëm, Te mjaftueshëm për një AP, ndoshta e tepruar.

4(katër) Dumper min. Pesha 32 t, e pa sqaruar janë kamion apo transportues dheu.

1(një) Dumper min. Pesha 70 t, bazuar në informacione teknike nga prodhuesi një Dumper i tillë nuk lejohet të qarkullojë neper rrugë dhe Autostrada sepse gjerësia dhe lartësia e tij është vetëm për miniera të madhësis, pyetja si do të transportohet deri të vendpunishjtja e varrezave ?

3(tre) Dumper min. Pesha 22 t, Gjithsejt 8 Dumper te ndryshëm ????

1(një) Kamion kiper, min. Pesha 40 t, Nuk e keni sqaruar bruto apo neto ?

1(një) Kamion me korpë, Ju lutemi na e sqaroni qfare korpe, behet fjale për ndriqim publike apo për ndonjë transport tjetër ?

3(tre) Kokë tërheqëse, 18 t, Ndoshta e keni fjalën për Kamion i cili barte pas vete një Gjysëmrimorkio, 18 t nënkupton pesha e Kokës tërheqëse apo bartese ?

3(tre) Gjysëmrimorkio kiper, min. Pesha 32 t, Ndoshta kjo lidhet me kokë tërheqëse ?? pyetja e jonë është cila ngjyre apo sa akse duhet të kenë keto Rimorkio, apo nuk ka mundësi të transportohet me ndonjë Alternative tjetër materiali i cili duhet të levizet (gërmohet apo mbushjet zhavorike)

1(një) Rimorkio për bartjen e automjeteve min. Pesha 24 t, pyetja e jonë është si ka mundësi që kjo Rimorkio kaq e vogël të bartë një Eskavator që ka peshë 73 t ?, apo OE të cilin ju e favorizoni nuk paska pas mundësi të blejë një Rimorkio më të madhe.

3(tre) Kamionetë dubelkabinë , Kamionetat dubelkabinë nenkupton qe bartin punëtorët dhe zakonishtë ka kete Struktura 7+1 qe do te thote pa vozitësin barte vetem 7 punëtor , si e keni menduar qe ata 29 punëtorët e tjere te udhetojn ?dhe a ka mundesi qe keta 50 punëtor kompani të kontraktoj nje Autobusë ?

2(dy) Ngarkues min. Pesha 35 t, Ngarkuesit nuk nevoiten ne kete projekt , por gjithsesi kemi nje pyetje , behet fjale per ndonje Seperacion , gurore apo baze per prodhimin e materialeve inerte apo punë ne varreza ?

2(dy) Ngarkues min. Pesha 24 t, Prapë dy ngarkues të tjerë ????

2(dy) Cilindër vibrues (makine ngjeshese), Nuk e keni sqaruar peshën ???

1(një) Cilindër vibrues me dhembëza, min. Pesha 21 t, Nuk është i nevojshem

1(një) Cilindër vibrues min. Pesha 25 t, Përdoret vetem ne raste kur ngjeshmëria kërkohet min 120 MVN

1(një) Grejder (makine per nivelizimin e rrugeve), min. Pesha 14 t, pa alternative

1(një) Çekan hidraulik, Ne kete projekt nuk kemi struktura shkembore e as material te kategoris V e tutje

2(dy) Auto pompë betoni, mundet vetem nje

4(kater) Kamion per transport te betonit (Autobetonierkë - mixer), Nuk ka sasi aq te madhe te betonit .

1(një) Kamion Cisternë , nuk e keni saktësuar qfare duhet te transportoj , Naftë apo ujë të pijes ? sepse ka cisterna qe transportojn edhe gymësht .

1(një) Autobotë , Autobotë për transport Çimentos apo ç'far Autobote ?

Pajisjet e nevojshme për punët e rrugëve

1(një) Finisher për asfaltimin e rrugëve, Nuk e keni saktësuar peshën apo Ngjyrën.

1(një) Makinë (Finisher) më rrota për asfaltimin e rrugëve , Pse bashë me rrota , dhe ju lutem na e specifikoni sa rrota duhet të ketë ?

1(një) Cilindrat me rrota të kombinuara (gomë dhe hekur), Nuk e ekni specifikuar peshën , ndoshta mund te jetë edhe më i vogël se 1 tonë.

2(dy) Cilindrat me rrota hekuri me vibrim, Nuk e keni specifikuar peshën , ndoshta mund te jetë edhe më i vogël se 1 tonë.

2(dy) Cilindër vibrusë min. Pesha 3t, Sigurishtë keni menduar per ngjeshjen e bankinave ?

1(një) Makine per shtrirjen e zhavorrit per bankina te rruges , Para disa ditëve kemi një senzacion ne Republikën tonë të dashur nje OE e ka shpallur si Risi të veten ne rrjetin social facebook se i pari ne Kosovë e ka Importuar nje makineri të tillë , e qka është më e keqja ju ne paramasen dhe parallogarine nuk keni te parapame bankina sepse ato i keni te kufizuar me skajore te rrugeve . pyetja jonë është kjo makineri nevojitet vetem si dekor apo per te kryer ndonje punë në këtë projekt.

1(një) Kamion (Autobotë për pastrimin e rrugëve dhe kanalizimeve), Nuk e keni të sqaruar ne DT se në qfarë periudhe duhet te mirëmbahen varrezat dhe sa ka nevojë per pastrim te rrugëve dhe kanalizimit ? Nuk e kuptojm qfarë nevojave ka ky projekt per nje makineri te tillë .

1(një) Spërkatës për bitumen dhe emulsion, Asfalti është 1 (një) shtresorë referojuni paramases nuk nevojitet Spërkatësja .

1(një) Makine për gërryerjen e asfaltit, Asfalti është 1 (një) shtresorë referojuni paramases nuk nevojitet Gërryesja , apo ndoshta me kete kontrate doni te realizoni edhe ndonje Ri-Shtresim ne ndonjeren nga rruget e qytetit apo fshatrave.

1(një) Kamion special fshisë për pastrimin e rrugeve, është mirmbajtje kjo apo ç'farë ?

1(një) Prerëse e asfaltit, Në cilin pozicion përdorët kjo ?

1(një) Kompresor, Kemi kompresor të ndryshëm cili kerkohet ?

7(shtatë) Kamion kiper min.Pesha 32 t, cila nga ngjyra e kamioneve ju përshtatet ?

Nga Sqarimet e lartëcekura dhe kërkesa jonë pasuese për Ri-shqyrtim shpresojm të jetë një mësim per AP në të ardhmen ?

Kërkesa 2 Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë në vlerë prej së paku 300,000.00 €

Dëshmia 2 Dokumenti të jetë i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar që dëshmon se OE i ka mjetet financiare në dispozicion lidhur për këtë projekt.

Kjo është komplet kërkes Diskriminuese sepse sipas Lpp-së dhe Legjislacionit dytësor kjo kërkes është e rregulluar dhe sqaruar në RRUOPP e datës 01.02.2021.

Sqarimi sipas Rruopp-së

Shënim për kërkesat e gjendjes ekonomike dhe financiare (neni 68 i LPP-se): • Qëllimi i këtij kriteri është që të vlerësojë nëse tenderuesi ka stabilitetin e të mjaftueshëm financiar dhe ekonomik për të përformuar kontratën e propozuar. Në përgjithësi, Operatorëve ekonomik u lejohe të plotësojnë këtë kërkesë duke paraqitur, nëse është me rëndësi dhe e nevojshme, një ose më shumë nga referencat e dhëna në vijim: 1. raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka; 2. evidencë të një police të sigurimit të lëshuar nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve; 3. kopjet e certifikuara të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilanci e gjendjes nëse kërkohet publikimi i bilanceve të tillë të gjendjes në kuadër të ligjit në vendin e themelimit të Operatorit ekonomik Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik 63 4. kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur; ose 5. deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës. 1. raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka Në rast të kontratave me vlerë të madhe, kur Operatori ekonomik ka për të financuar zbatimin e kontratës, është e dobishme për të kërkuar shumë të caktuar të likuiditetit ose për të njëjtën vlerë shënim premtues për kredi. Mund të sigurojë se Operatori ekonomik do të merr kredi nga banka në rast nevojë, ose kompania ka të holla (cash) dhe është në gjendje të zbatojë kontratën pa kredi. Për më tepër, banka mund të vërtetojë se Operatori ekonomik paguan rregullisht pa vonesë shpengimin e tij të kreditit, e cila gjithashtu është një garanci se Operatori ekonomik ka sfond solid financiar.

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ketë qarkullim në 3 vitet e fundit (2013-2014-2015) jo më pak se 500.000 Euro si mesatare e 3 viteve. Dëshmia dokumentare 1. Deklarate nga Banka për të ardhurat vjetore të kompanisë. Shembull i mire: Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 500.000 euro asete likuide financiare (për shembull në llogarinë bankare) ose të paktën 500.000 euro qasje për kredi në dispozicion.

Dëshmia dokumentare 1. Deklarata nga banka që vërteton disponueshmërinë e 500.000 euro në llogarinë bankare të kompanisë apo një vërtetim bankar (shënim premtues) që konfirmon se kompania mund të merr kredi prej 500.000 EUR, nëse është e nevojshme. Data e deklaratës bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjalë.

Ju lutemi mos dilni jashtë Lpp-së dhe Rruopp-së , sepse pasojat mund të dalin ndaj neve si OE në moskonkurim ndërsa ju si përfaqësues të popullit për menagjimin e finacave oubleke mund të përgjigjeheni për keqperdorim të tyre.

Duke eliminuar kriteret diskriminuese të panevojshme , Iso Standarte , Ingjinjer të Komunikacionit , pagesat e punëtorëve me dëshmi nga banka Paisje që as në Autostradën Ibrahim Rugova apo Arbër Xhaferi nuk janë përdorë dhe asesi nuk ishin si kriter i vlerësimit për një AP me vlerë të madhe sipas Lpp-së por asesi e përfaqësojë me dy Autostradat dhe duke kërkuar kriteret që ndoshta ndonjë kompani edhe mund të plotësojë ju si AK jeni plotësisht në kundërshtim me nenet 1 , 6 , 7 , 59 , 60 dhe kjo është e pa justifikueshme , andaj ju lutemi për hirë të korrektësis dhe transparencës veproni me kohë sepse ne jemi të detyruar që rrugëtimin tonë për keto pa-drejtësi ta kërkojmë edhe ne Organet të tjera Vendimë Marrëse , sepse jemi tatimpagues i shtetit tonë dhe deshirojmë të mbrojmë vlerat e një Shteti Funkcional dhe të barabartë për të gjithë OE.

8/1

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Nese ne si OE nuk mund ti plotëson te gjitha keto kritere diskriminuese , mbetet ne ndergjegjejen tuaj dhe ne te drejtat tona do ti kerkojm ne organet kopetente duke perfshi edhe instancat me te larta po qe se eshte e nevojshme

Dëmi finaciar dhe material eshte i pa riparueshëm , sepse ne edhe po të bëjm konzorcium me Bechtell Encha nuk besoj se do ti plotesonin keto kritere aq te Ekzagjeruara .

Mbesim me shprese se kesaj radhe do te hasim ne mirkuptimin tuaj per hire te bashkpunimit nga e kaluara dhe bashkpunimve ne te ardhmen .

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *Te gjitha komunikimet me AK .*